

## Aneks 1

Formulari i deklarimit te te dhenave dhe dokumenteve te pajtimtarit qe kerkon bartjen<sup>9</sup>

	Operatori Marrës
1	Numri i telefonit që do të bartet:
2	Emri i pajtimtarit:
3	Numri Unik Personal (nëse pajtimtari është <b><u>i regjistruar te operatori Dhënës si</u></b> individ):
4	Numri NIPT ( <b><u>nëse pajtimtari është person fizik ose juridik, i regjistruar me numer NIPT</u></b> ):
5	Numri i telefonit do të bartet nga rrjeti i (“operatori Dhënës”):
6	Numri i telefonit do të bartet në rrjetin e (“operatori Marrës”):
7	<b><u>Data/ora e depozitimit të Kërkesës nga pajtimtari te OM<sup>10</sup>: dd/mm/viti Ora: hh.mm</u></b>
8	<b><u>Data kur do të realizohet bartja/aktivizohet numri i bartur: brenda 1 (një) dite pune nga data/ora hedhjes së kërkesës në sistemin CRDB nga OM ose më datë dd/mm/viti</u></b>

***Pajtimtari:***

***Emër Mbiemër, Nënshkrimi***

***Për operatorin:***

***Nënshkrimi, Vendi dhe Data***

<sup>9</sup> Pajtimtari pajiset me një kopje të printuar ose elektronike të formularëve të plotësuar sipas Aneks 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje

<sup>10</sup> Nëse Operatori Marrës dërgon kërkesën në sistemin CRDB në një kohë të ndryshme nga depozimi i kërkesës, Operatori Marrës celular njofton me SMS pajtimtarin për kohën e hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës, e cila nuk do të jetë me vonë se 1 (një ditë) pune nga koha e depozitimit të kërkesës nga pajtimtari.

## ANEKS 2

### Formulari i deklarimit që pajtimtari duhet të nënshkruajë me operatorin Marrës

Unë, i nënshkruari, jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri të telefonit do të thotë që numri i plotë tranferohet nga rrjeti i një operatori (“operatori Dhënës”) në rrjetin e një operatori tjetër (“operatori Marrës”). Si pajtimtar i një shërbimi telefonik kam të drejtën të kërkoj bartjen dhe që të dy, operatori dhenes dhe marres janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Unë kërkoj bartjen nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti dhe formularit të deklarimit të të dhënave dhe paraqitjes së tij tek operatori Marrës, i cili **udhëheq procesin** e bartjes dhe duhet te ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin. **Operatori Marrës do të më njoftojë për ecurinë e procesit të bartjes.**
- b) Kontrata ime ekzistuese me operatorin Dhënës do të përfundojë në kohën kur bartja bëhet efektive, por bartja nuk do të përfundojë detyrimet ekzistuese kontraktore me ODH.
- c) **kërkesa për bartje për një numër me paspagim mund të pranohet nga operatori Dhënës por ajo nuk do të ekzekutohet në rast se kam detyrime ndaj operatorit Dhënës sipas përcaktimeve të kontratës ekzistuese që unë kam me operatorin Dhënës.** Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj operatorit Dhënës, këto çështje duhet ti sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin Dhënës.
- d) Operatori Marrës është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet ti paguaj operatorit Marrës dhe nëse unë mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e operatorit Marrës.
- e) **Operatori marrës do më njoftojë (me SMS për operatorët celularë) për kohën e hedhjes në sistemin CRDB të kërkesës për bartje (nëse kjo kohë është e ndryshme nga koha e depozitimit të kërkesës sime tek operatori marrës) dhe:**
  - a. **Unë si pajtimtar nuk mund të kërkoj anulimin e procesit të bartjes së numrit pasi kërkesa është hedhur në sistem.**
  - b. **Operatori Dhënës nuk mund të më japë oferta/bonuse apo kushte të tjera favorizuese individuale pasi kërkesa është hedhur në sistemin CRDB dhe gjatë procesit të saktësimit të të dhënave.**
- f) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifat e kontratës së re, do ti sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin Marrës para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit Dhënës dhe dëshiroj të nderpres kontaktën me operatorin Dhënës.
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin Marrës sipas termave dhe kushteve kontraktore, përfshirë tarifave të shërbimeve të cilat më janë paraqitur nga operatori Marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin e përmendur nga rrjeti i operatorit Dhënës në rrjetin e operatorit Marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin Marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit Dhënës për nderprerjen e kontratës time ekzistuese.

***Pajtimtari:***

***Emër Mbiemër, Nënshkrimi***

***Vendi, Data, Ora***